



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 01
Data 06. 02. 2008

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri të mbajtur më
06.02.2008.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N -225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin: Shkumbin Demalija, Bojan Stojanovič, Emrush Xhemajli, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Agim Veliu, Naim Maloku, Gani Geci dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi

Nga Sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Ibush Mujaj (koordinatori i Komisionit),
Antigona Ibraj (zyrtare ligjore), Nur Çeku (DCAF), Biljana Petrovič (DCAF)

Në fillim të mbledhjes kryetari i Komisionit anëtarëve të Komisionit u dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e parë të këtij komisioni në legjislaturën e re të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu përshëndeti edhe përfaqësuesit e OBE-së dhe të organizatave të tjera që përcjellin punën e Komisionit dhe i ftoj për bashkëpunim. Ai gjithashtu bëri një prezantim të shkurtër të tij dhe më pas propozoi të vazhdonte mbledhja me këtë dite:

RENDI I DITËS

- 1. Konstituimi i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri**
- 2. Njoftim nga OSCE-ja për programin e trajnimit**
- 3. Të ndryshme**

Pika e parë: Në pikën e parë të rendit të ditës z.Rrustem Mustafa bëri një prezantim të anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe theksoi se kjo mbledhje ka më tepër karakter njohës për anëtarët dhe për natyrën e punës së Komisionit. Gjithashtu propozoi të hartohet një plan pune për këtë komision. Prandaj kërkoi nga anëtarët e këtij komisioni që secili prej tyre të kontribuojë në hartimin e këtij plani. Ndërsa sa i përket orarit të punës tha se, kjo nuk do të varet vetëm nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, por edhe nga vetë rrjedha e ngjarjeve që do të zhvillohen. Ai me pas fjalën ia dha z.Naim Maloku për të bërë një prezantim të shkurtër të punës së këtij komisioni në mandatin e kaluar pasi që ka qenë kryetar i këtij komisioni.

z.Naim Maloku- Pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi se ky komision që në fillim ka qenë Komision për Gatishmëri dhe Emergjencë, por më vonë është ngritur në Komision për Siguri. Ne kemi bërë një propozim për një emërtim të ri për shkak se ky komision mbikëqyr Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ju e keni para vetes fushë veprimtarinë e këtij komisioni, por ne gjithashtu duhet t'i shqyrtojmë burimet financiare të cilat rrezikojnë sigurinë e Kosovës, pra duhet t'i përcjellim se nga vijnë këto burime. Pastaj çështja e të zhdukurve është çështje me rëndësi, pra ne duhet ta përcjellim sa ndikon zvarritja e procesit të të zhdukurve në sigurinë e brendshme të Kosovës. Këto i propozoj t'i fusim në fushë veprimtarinë e Komisionit. Ai cekti edhe bashkëpunimin me organizatat e tjera, duke theksuar se kemi pasur bashkëpunim të mirë me DCAF-in. Gjithashtu tha se kemi pasur bashkëpunim të mirë edhe me OJQ-në KIPERED dhe propozoi të vazhdonte bashkëpunimi me ta në mënyrë që t'i kemi në mbështetje gjatë shqyrtimit të ligjeve. Ai tha se gjatë mandatit të kaluar kemi pasur edhe disa vizita jashtë vendit si në Maqedoni, Slloveni, Kroaci etj, për të mësuar dhe shkëmbyer përvojat me komisionet homologe të këtyre vendeve. Të gjitha këto na kanë shërbyer në punën tonë.

z.Naim Maloku propozoi që mënyra e shqyrtimit të ligjeve të mbetet ashtu siç ka qenë në mandatin e kaluar, duke theksuar se nëse do të mbetet kjo mënyrë unë jam i gatshëm të jem kryesues për projektligjin e parë dhe për bashkëpunim.

z. Emrush Xhemajli, pasi përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi z.Naim Maloku për prezantimin e punës së mëparshme të këtij komisioni tha se mbet pa u thënë diçka edhe në lidhje me dëgjimet publike.

z.Rrustem Mustafa, tha se stafi mbështetës po i bën përgatitjet për një informim më të hollësishëm dhe për çdo gjë mund të informoheni te stafi.

z.Gani Geci, pasi përshëndeti të pranishmit e bëri një pyetje. Çka është shoqëria informative?

z.Naim Maloku, shoqëria informative mund të jetë shërbimi informativ sekret, por përfshin edhe mediumet, që ne i shqyrtojmë dhe nëpërmjet komisionit për media

mund të kërkojmë që t'u tërhiqet vërejtja se ky ose ai informacion po ndikon negativisht në sigurinë e Kosovës.

z.Shkumbin Demalija, pasi përshëndeti të pranishmit, tha „ Unë besoi që puna ime do të jetë e vlefshme për këtë komision,, mirëpo më tepër tha,, Kisha dashur t'i referohem legjislacionit që këto ligje të na dërgohen në mënyrë elektronike sepse kjo na mundëson që të jemi sa më të dobishëm në punën tonë.

Pika e dytë: Në pikën e dytë të rendit të ditës **z.Rrustem Mustafa**, njoftoi të pranishmit për mbështetjen që i ka dhënë dhe do t'i japë këtij komisioni OSBE-ja, dhe fjalën ja dha përfaqësuesit të OSBE-së **z. Luis Moratinos-Munoz**

z. Luis Moratinos-Munoz, përshëndeti kryetarin e këtij komisioni dhe theksoi „ Do të kemi bashkëpunim të mirë ashtu siç kemi pasur edhe deri me tani me **z.Naim Maloku**,,. Ai i njoftoi anëtarët e Komisionit që OSBE do të ketë një trajnim me ta me datën 11 e 12 shkurt si dhe me 18 e 19 shkurt.

Mirëpo me kundërshtimin e disa anëtarëve të Komisionit, **z.Rrustem Mustafa**, kërkoj nga OSBE-ja që ta sjellin një referim në lidhje me trajnimin dhe pastaj të merren vesh rreth datave të mbajtjes së trajnimit.

Pika e tretë: Në pikën e tretë të rendit të ditës- të ndryshme- kryetari i Komisionit **Z.Rrustem Mustafa**, përmendi **Projektligjin për përdorimin civil të eksploziveve** që është në kompetencë të këtij komisioni i cili së shpejti do të jetë në lexim të parë. Gjithashtu tha se do të kemi edhe shumë ligje të tjera dhe se do të bëjmë kërkesë që projektligjet që vinë nga **Pakoja e Ahtisarit**, të na sjellën më herët, në mënyrë që të dimë se me çka kemi të bëjmë në to.

Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan, që ligjet që janë në pako të **Ahtisarit** të vinë më parë në mënyrë që të shqyrtohen më shumë e më mirë.

Kryetari i komisionit **z.Rrustem Mustafa** e përfundoi këtë takim dhe konkludoi që stafi të bashkëpunojë me OSBE-në, në lidhje me trajnimin që do të organizohet. Gjithashtu tha se do të bëhet kërkesë që ligjet e pakos së **Ahtisarit** të vijnë më herët për shqyrtim në këtë komision.

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit